



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr.56

Datë 23 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8541 datë 18.4.2014	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	2149
Udhëzim i MTI nr. 2, datë 17.4.2014	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 2, datë 11.2.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”	2149
Udhëzim i MZHUT nr. 4, datë 14.4.2014	Për zbatimin e vendimit nr. 199, datë 2.4.2014 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa në vendimin nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores model të planifikimit”, të ndryshuar”	2149
Urdhër i MZHUT nr. 75, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2150
Urdhër i MZHUT nr. 76, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2150
Urdhër i MZHUT nr. 77, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2151
Urdhër i MZHUT nr. 78, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2151
Urdhër i MZHUT nr. 79, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2151
Urdhër i MZHUT nr. 80, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2152

Urdhër i MZHUT nr. 81, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2152
Urdhër i MZHUT nr. 82, datë 9.4.2014	Për delegim kompetence	2152
Vendim i KNSH nr. 45, datë 28.3.2014	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)”	2153
Vendim i KNSH nr. 46, datë 28.3.2014	Për shqyrtimin e VKM-së nr. 1101, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”, si edhe VKM-së nr. 1102, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”	2154
Vendim i KNSH nr. 47, datë 28.3.2014	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”	2155

DEKRET
Nr. 8541, datë 18.4.2014

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Arben Rakip Shini
1. Arlind Arben Shini
3. Emanuel Arben Shini
4. Blerina Ismet Shini (Sallaj)
5. Brisilda Arben Shini
6. Arjan Mustafa Xhabafti
7. Vitjola Hair Xhabafti (Baçi)
8. Mekey Arjan Xhabafti
9. Kejsi Arjan Xhabafti
10. Maria Vladimir Lilo
11. Fadil Maliq Havolli
12. Bore Qerim Gjocaj (Trezhnjeva)
13. Gözim Abaz Gjocaj
14. Egzon Abaz Gjocaj
15. Daut Abaz Gjocaj
16. Mimoza Adil Bengu-Kalf (Bengu)
17. Migena Gazmend Tomini
18. Ulpian Besnik Aliaj
19. Luljeta Xhevit Qafmolla

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr. 2, datë 17.4.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2,
DATË 11.2.2010 "MBI KONTROLLIN TEKNIK TË
MJETEVE RRUGORE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

dhe në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

1. Në nenin 1, pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

"6. Drejtuesit e mjeteve rrugore duhet të dorëzojnë te subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik vjetor KTV kontratën e sigurimit të mjetit. Në të kundërt ky shërbim nuk kryhet."

2. Në nenin 5, në fund të pikës 4 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

"Në certifikatën e kontrollit teknik do të shënohet numri i serisë së kontratës së sigurimit të mjetit dhe emri i kompanisë që e ka lëshuar."

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

UDHËZIM
Nr. 4, datë 14.4.2014

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 199, DATË
2.4.2014 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR
DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 480, DATË
22.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË
PLANIFIKIMIT", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 944, datë 9.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit", si dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 2.4.2014 të Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa në vendimin nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në përputhje me nenin 4 të shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar, duhet të shprehet mbi kërkesat për kontrollin e përputhshmërisë me instrumentet kombëtare dhe/ose

vendore të planifikimit, të miratuara ose në proces, për të gjitha zhvillimet që kërkohet të kryhen, përfshirë dhe në zonat e pezulluara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

2. Autoritetet e planifikimit të territorit, përpara shqyrtimit të kërkesave për zhvillim, dhe si kusht për dhënien dhe ligjshmërinë e lejeve zhvillimore për kategoritë e përmendura në pikën 1, germa "a", "b", "c" dhe "d", të nenit 4 të shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar, përfshirë dhe në zonat e pezulluara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, kanë detyrimin të kërkojnë paraprakisht konfirmim nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për përputhshmërinë e zhvillimit që propozohet për t'u kryer me instrumentet e planifikimit, të miratuara ose në proces, përfshirë me politikat e strategjitë sektoriale, kombëtare apo vendore.

3. Për marrjen e konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, autoritetet e planifikimit të territorit dhe/ose zhvilluesit duhet të paraqesin, të paktën:

-kërkesë për kontrollin e përputhshmërisë;

-vërtetimin nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe planvendosjen e pronës ku propozohet të kryhet zhvillimi;

-projektin zhvillimor, kur të evidentohen treguesit e zhvillimit;

-hartën e përdorimit ekzistues të tokës në një rreze 1.5 km nga zhvillimi i propozuar.

4. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, me marrjen në dorëzim të kërkesës si më sipër, shqyrton përputhshmërinë e zhvillimit të propozuar me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit, të miratuara ose në proces, dhe bashkërendon veprimet me autoritetet e tjera të planifikimit. Pas shqyrtimit, përgatit informacionin përkatës dhe vë në dijeni Këshillin Kombëtar të Territorit.

5. Njoftimi për Këshillin Kombëtar të Territorit bëhet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në dy mënyra. Njoftimi bëhet në mbledhjen e radhës së Këshillit Kombëtar të Territorit ose me anë të njoftimit të anëtarëve dhe kryetarit sipas procedurës dhe njoftimit të tyre si në rastin e njoftimit për mbledhjet e KKT-së.

6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit shprehet brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës për kontrollin e përputhshmërisë.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

8. Pas hyrjes në fuqi të tij, udhëzimi publikohet në portalin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

URDHËR
Nr. 75, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa "a", të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

URDHËR
Nr. 76, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa "a", të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

URDHËR

Nr. 77, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Arkivit Qendror Teknik, të Ndërtimit.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

URDHËR

Nr. 78, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

URDHËR

Nr. 79, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik

Kombëtar jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

**URDHËR
Nr. 80, datë 9.4.2014**

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Institutit të Ndërtimit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

**URDHËR
Nr. 81, datë 9.4.2014**

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Entit Kombëtar të Banesave jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

**URDHËR
Nr. 82, datë 9.4.2014**

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Zyrës së Shërbimit Turistik jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Zyrës së Shërbimit Turistik.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Zyrës së Shërbimit Turistik të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Zyrës së Shërbimit Turistik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

VENDIM

Nr. 45, datë 28.3.2014

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT TË EKONOMISË KREATIVE (ARTIZANATI)”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare
- Z. Edmond Ademi anëtar
- Z. Ahmet Maçellari anëtar
- Znj. Anduena Dedja anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 28.3.2014, shqyrtoi raportin për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe është regjistruar në regjistrin me nr. AI/N/14/2014.

OBJEKTIVI/AT: Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv zhvillimin e sektorit të artizanatit dhe zejtarisë në Shqipëri, duke krijuar një mjedis të favorshëm për aktivitete më të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

BAZA LIGJORE: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 5.9.2012 “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)”, si edhe udhëzimi i përbashkët nr. 1, datë 20.2.2014 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të fondit të ekonomisë kreative (artizanati)” i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Financave.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Mbështetja financiare do të jepet për projekte në sektorin e artizanatit që mbulojnë zhvillimin e

produkteve të reja, marketingun e tij, si dhe kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjes aplikuese. Pa ndihmën e shtetit, këto aktivitete nuk do të mund të ndërmerreshin, për shkak të mungesës së burimeve financiare të domosdoshme për realizimin e projekteve tregtare.

2. Skema ka një kohëzgjatje zbatimi 4 (katër) vjet. Llogaritja e kohëzgjatjes fillon nga momenti kur skema do të nisë zbatimin në vitin e parë të saj.

3. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

4. Përfitues të ndihmës do të jenë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që operojnë në sektorin e artizanatit sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të fondit.

5. Ndihma do të jepet në formë subvencioni nga buxheti i shtetit për ndërmarrjen përfituese. Shuma gjithsej e ndihmës, sipas skemës së njoftuar është 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një periudhë zbatimi prej 4 (katër) vitesh. Intensiteti maksimal i ndihmës për një përfitues në varësi të projektit konkurrues është 60% deri në 80% e kostove të pranueshme dhe të miratuara brenda kufirit prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh.

6. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) sjell pasoja mbi konkurrencën.

a) Prezenca e burimeve shtetërore

Ndihma financohet nga burime shtetërore; autoritetet shtetërore (MZHETS-ja dhe AIDA) menaxhojnë dhe kontrollojnë fondin e ekonomisë kreative (artizanati), përzgjedhin përfituesit dhe kryejnë pagesën nëpërmjet fondit.

b) Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

Përfituesit e financimit publik kryejnë një aktivitet ekonomik në sektorin e artizanatit dhe zejtarisë, duke prodhuar produkte, të cilat tregtohen brenda dhe jashtë vendit. Skema favorizon ndërmarrje të caktuara kundrejt ndërmarrjeve të tjera. Masa është selektive dhe i jep një avantazh ekonomik përfituesve të saj.

c) Pasoja mbi konkurrencën

Zbatimi i skemës do të nxisë zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në tregun e artizanatit, me qëllim krijimin e produkteve të reja me origjinë shqiptare, për të cilat do të rritet interesi edhe nga ana e turistëve të huaj. Zbatimi i skemës do të zgjerojë përfitimin e saj, duke mundësuar zhvillimin nga pikëpamja sociale-ekonomike dhe kulturore e zonave të ndryshme në Shqipëri. Pasoja në konkurrencën në treg është e vogël.

7. Masa përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore dhe bie brenda fushëveprimit të nenit 13 (c) të ligjit, duke qenë se objektivi i skemës është nxitja e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve që operojnë në fushën e artizanatit, të cilët nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të investuar në zhvillimin e produktit, dhe se ndihma jepet deri në atë masë sa nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 13, shkronja “c” dhe nenit 17, shkronja “a”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)”.

2. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

3. Të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

VENDIM Nr. 46, datë 28.3.2014

PËR SHQYRTIMIN E VKM-së NR. 1101, DATË 28.12.2013 “PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË RAIFFEISEN BANK ALBANIA SHA, NË KUADËR TË KUSHTEVE TË KONTRATËS SË KREDISË, NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH SHA”, SI EDHE VKM-së NR. 1102, DATË 28.12.2013 “PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, NË KUADËR TË KONTRATËS SË HUAS, NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH SHA”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|----------|
| - Z. Arben Ahmetaj | kryetar |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare |
| - Z. Edmond Ademi | anëtar |
| - Z. Ahmet Maçellari | anëtar |
| - Znj. Anduena Dedja | anëtare, |

në mbledhjen e tij të datës 28.3.2014, mori në shqyrtim dy akte nënligjore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave: VKM nr. 1101, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”, dhe VKM nr. 1102, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”.

OBJEKTI: Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore në VKM-në nr. 1101, datë 28.12.2013 dhe VKM-në nr. 1102 datë 28.12.2013.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, si dhe VKM-ja nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. KESH sh.a. është një ndërmarrje, forma juridike e së cilës është shoqëri anonime me 100% kapital shtetëror. Ndërmarrja ka si objektiv prodhimin dhe garantimin e energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët fundorë tariforë dhe luan një rol aktiv në tregun e energjisë.

2. KESH sh.a. ka partner/klient kryesor kompaninë “CEZ Shpërndarje”. Detyrimet e prapambetura janë akumuluar që nga viti 2011 dhe përfshijnë faturat e papaguara për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve tariforë, për mbulimin e humbjeve dhe importin e realizuar. KESH sh.a. i është drejtuar bankave tregtare për sigurimin e kredisë së nevojshme për blerjen e energjisë elektrike dhe furnizimin e konsumatorëve.

Ministria e Financës, me dy vendime të Këshillit të Ministrave, ka miratuar garancinë qeveritare në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a. dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kredisë ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a.

3. Në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) sjell pasoja mbi konkurrencën.

a) Burime shtetërore

Sipas nenit 34 të ligjit për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas¹, miratimi i garancisë shtetërore për huan nuk përbën

¹ Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”.

detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Miratimi i garancisë shtetërore aktivizon potencialisht burime shtetërore.

b) Avantazhi ekonomik

Sipas legjislationit evropian², garancia shtetërore konsiderohet se nuk jep një avantazh ekonomik për një ndërmarrje, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: I) huamarrësi nuk është në vështirësi; II) garancia lidhet me një transaksion financiar specifik; III) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huas; dhe IV) për garancinë paguhet një çmim tregu.

I) Sipas rregullores për ndihmën shtetërore për shpëtim dhe ristrukturim³, si edhe mbështetur në të dhënat ekonomiko-financiare për periudhën 2010-2012, ndërmarrja KESH sh.a. nuk konsiderohet një ndërmarrje në vështirësi.

II) Garancia e lëshuar nga Ministria e Financave lidhet me një transaksion të përcaktuar financiar, për një shumë të caktuar maksimale, e cila është e kufizuar në kohë deri në kthimin e plotë të të gjitha shumave që KESH sh.a. u detyrohet bankave.

III) Sipas legjislationit që zbatohet në sektorin e energjisë⁴, organizimi i tregut të energjisë elektrike dhe funksionimi i sistemit elektro-energjetik realizohet si shërbim publik. KESH sh.a., si furnizues publik me shumicë, është i vetmi subjekt i licencuar në vend për blerjen e energjisë elektrike nga gjenerimi publik, prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike apo prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike dhe tregtuesit, për nevojat e klientëve tariforë.

IV) KESH sh.a. i ka kërkuar në treg të hapur bankave tregtare ofertat fillestare për shumën dhe termat kryesorë të akordimit të kredisë. Primi dhe normat e interesit, të ofruara nga bankat, reflektojnë normën e tregut. Ofertat kanë qenë objekt i rishikimit lidhur me kushtet e kredisë dhe nga ndërmarrjes është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme.

Miratimi i garancisë shtetërore për lidhjen e marrëveshjes së kredisë, nuk i jep KESH sh.a. avantazh ekonomik.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, shkronja "d", dhe 25, 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

² Njoftimi i Komisionit mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore në formën e garancisë 20.6.2008.

³ VKM nr. 816, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim", neni 3, shkronja "a".

⁴ Ligji nr. 9072 datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 25 dhe VKM nr. 338, datë 19.3.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike".

VENDOSI:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1101, datë 28.12.2013 "Për miratimin e garancisë qeveritare", të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.", dhe VKM nr. 1102, datë 28.12.2013 "Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.", nuk përbëjnë ndihmë shtetërore.

2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 47, datë 28.3.2014

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS
SHTETËRORE "PËR PROGRAMIN E NXITJES
SË PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUAR"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare
- Z. Edmond Ademi anëtar
- Z. Ahmet Maçellari anëtar
- Znj. Anduena Dedja anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 28.3.2014, shqyrtoi raportin për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar". Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me shkresën nr. 1355, datë 10.3.2014 dhe është regjistruar në regjistrin me nr. AI/N/15/2014.

OBJEKTIVI/AT: Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv nxitjen e punësimit, duke i ofruar lehtësi ndërmarrjeve, të cilat punësojnë persona me aftësi të kufizuar nëpërmjet kontratave vjetore të punës. Masa ka si qëllim lehtësimin e integritit të kësaj kategorie në tregun e punës, jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.

BAZA LIGJORE: Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar" i iniciuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Mbështetja financiare do t'u jepet ndërmarrjeve, të cilat punësojnë persona me aftësi të kufizuar nëpërmjet kontratave vjetore të punës.

2. Masa ka një afat të përcaktuar kohor prej 5 vitesh. Llogaritja e kohëzgjatjes fillon nga momenti kur skema do të nisë zbatimin në vitin e parë të saj.

3. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj mase është Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

4. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që punësojnë personat me aftësi të kufizuar, si edhe ndërmarrjet, të cilat kanë mundësi të punësojë këta persona kundrejt përshtatjes së vendit të punës.

5. Skema zbatohet në të gjithë sektorët e ekonomisë, për punëdhënës, të cilët nuk duhet të kenë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës, si edhe duhet të kenë derdhur rregullisht tatimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

6. Mbështetja do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit, që alokohen çdo vit për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Ndihma do t'u jepet ndërmarrjeve që paraqesin projektet për punësim dhe do të jenë objekt i shqyrtimit dhe i vlerësimit nga pikëpamja e dobisë social-ekonomike. Projektet fituese do të përfitojnë format e mbështetjes nga fondet e nxitjes së punësimit, si:

- Një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit;

- Financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transport personit me aftësi të kufizuar dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100.000 lekë, por jo më shumë se 200 000 lekë, nëse punëson më shumë se dy persona;

- Financim të shpenzimeve të trajnimit të ofruar nga ndërmarrja deri në 70% të tarifave.

8. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) sjell pasojë mbi konkurrencën.

a) Prezenca e burimeve shtetërore

Masa mbulon koston e pagës për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, financimin për të pajisur siç duhet vendin e punës, si edhe financimin e shpenzimeve të trajnimit të ofruar nga ndërmarrja. Të tria format aktivizojnë burime shtetërore nga fondet e buxhetit të shtetit.

b) Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

Masa ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet, që lidhin kontrata afatshkurtra të punës. Ulja e koston së punës për këto ndërmarrje përmirëson pozitën ekonomike të tyre. Ndihma jepet vetëm për punëdhënësit, projektet e të cilëve përzgjidhen fitues nga komisioni i miratimit të projekteve.

c) Pasoja në konkurrencë

Kohëzgjatja e masës është e shkurtër dhe efekti në konkurrencën në treg është i vogël.

9. Mbështetur në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, neni 10 "Ndihma për punonjësit në vështirësi dhe për punonjësit me aftësi të kufizuar", intensiteti i skemës së ndihmës nuk e kalon kufirin e lejuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 dhe 17, shkronja "a" të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar, si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Të gjitha planet, të cilat ndryshojnë masën e ndihmës, duhet të njoftohen dhe marrin miratimin paraprak të KNSH-së.

3. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, brenda datës 31 mars, të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006